

### ❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektesh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

### ❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Koordinator i Mjedisit dhe Ceshtjeve Sociale

### ❖ PERSHKRIMI I POZICIONIT

Koordinatori i Mjedisit dhe Ceshtjeve Sociale ne kantier përgjigjet për koordinimin e punëve për realizimin dhe implementimin e kërkesave të sistemit ISO 14001 dhe planeve të menaxhimit të mjedisit ,planeve të rehabilitimit dhe procedurave specifike në kantier.Ai/Ajo përgjigjet për mbarëvajtjen ,monitorimin e sistemit të menaxhimit të mjedisit gjatë ushtrimit të aktiviteteve ndërtimore të kompanisë si dhe menaxhimin e ceshtjeve sociale.

### ❖ DETYRAT KRYESORE

- Siguron zbatimin e kërkesave ligjore ne lidhje me ceshtjet e mjedisit , si dhe zbatimin e procedurave dhe standarteve sipas ISO 14001 per aktivitetin e ushtruar nga kompania ne kantier.
- Koordinon dhe verifikon progresin e punës sipas specifikimeve dhe sistemit mjedisor dhe social në kantieret e ndërtimit.
- Kryen inspektime në kantiere në lidhje me përputhshmërinë me kuadrin ligjor institucional si dhe auditime të sistemit të mjedisit,përpuethshmerinë e kompliancës mjedisore sipas standarteve të kërkuara
- Krijon ,mirëmban ,përditëson database lidhur me rekordet e dhura sipas procedurave në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe vlerësimit të performancës mjedisore të kompanisë ne kantier.
- Asiston ne hartimin e planeve te menaxhimit , rehabilitimit , monitorimit dhe plane dorezimi te objektit;
- Drafton plane për zbutjen e ndikimeve në mjedis nga aktivitetet ndërtimore të kompanisë.
- Implementon programet e kontrollit për reduktimin e rreziqeve dhe incidentet mjedisore.
- Siguron evidentimin ,raportimin në kohë të të gjitha incidenteve mjedisore .
- Te adresojë te gjitha ankesat lidhur me projektin , te rregjistroojë dhe menaxhojë deri ne zgjidhjen e tyre
- Te mbajë rekorde mbi ankime dhe rregjistrin perkates te ankesave te ardhura nga palet e treat /komuniteti.
- Te verifikoj dhe siguroj informacion per cdo ankesë te marre, te japë opinionin e tij lidhur me ankesën
- Te ndjek mbylljen e ankesave dhe te pasqyrojë ata ne regjistrin e ankesave .

### ❖ KRITERET KRYESORE

- Master Shkencash ne Inxhinieri Mjedisit ose fusha relevante si Shkencat Natyrore (kimi industriale, biologji) , Inxh. Pyjesh ,Studime ne universitetet e vendeve te BE,
- Njohuri te mira te gjuhes angleze, I certifikuar per sistemet ISO 14001;
- Mbi 5 vite experience pune: Mbi 3 vite ne fushen e implementimit te sistemit te menaxhimit te mjedisit 14001, kuadrit ligjor mjedisor dhe mbi 3 vite si Koordinator projektsh apo njesive operacionale ne fushen e mjedisit.Preferohet me eksperience ne hartime te planeve të menaxhimit të mjedisit dhe auditime mjedisore.Eksperience ne implementim te projekte te financuara nga EBRD/World Bank/KfW ;
- Njohuri te programeve kompjuterike, Microsoft Office;

- Te jete i gatshem te punoje jashte Tirane.

Te gjithë te interesuarit, jane te lutur qe te dergojne CV nepermjet adreses se e-mailit [careers@gener2.al](mailto:careers@gener2.al) ose te plotesojne formularin e aplikimit ne faqen zyrtare [www.gener2.al](http://www.gener2.al) ne seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit eshte **data 25 Maj 2022, ora 17:00**.

\* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

\* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi “Mbrojtjen e të dhënave personale